



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 50, Datë 31.05.2017

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.84 DATË 29.12.2016 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2017-2019 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2017” (I NDRYSHUAR) SI DHE MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR PER AGJENCINË E PARQEVE DHE REKREACIONIT” .

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja (b), nenit 23 pika 9, nenit 27 pika 5, nenit 54 gërma (ç) dhe (dh), nenit 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; neneve 140 dhe 149 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” (i ndryshuar); nenit 113 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë; Vendimit nr.28, datë 23.05.2016 të Këshillit Bashkiak “Për kalimin e funksioneve të Mirëmbajtjes së rrugëve Rurale, Ujitjes dhe Kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, si dhe Administrimit të Pyjeve e Kullotave pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; Vendimit nr.84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar); Urdhërit nr.17306, datë 10.05.2017 të Kryetarit të Bashkisë “Për riorganizimin e strukturës dhe organikës si dhe klasifikimin e vendeve të punës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; me propozim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në Vendimin Nr.84 datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”(të ndryshuar) bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2/2.2 ndryshohet si më poshtë:

“ 2/2.2 Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit t’i shtohen 7 (shtatë) punonjës. Numri total i punonjësve të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit bëhet 278 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë) punonjës.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“ 3. Kontrata me kohëzgjatje të caktuar, për 75 (shtatëdhjetë e pesë) punonjës me pagë bazë 30,000 lekë/muaj në Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, shtyhet edhe për një afat 4 (katër) mujor për periudhën (01.06.2017-30.09.2017).

3. Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit ti shtohen 20 (njëzet) punonjës me pagë bazë 30,000 lekë/muaj, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për një periudhë 4 mujore (01.06.2017-30.09.2017).

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2017 për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI